



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E DYTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.02.2021 (e enjte)**, në zyrën e konferencave ne objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen,

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje media të shkruara dhe elektronike, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Meqenëse dje kemi pasur 13-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, më lejoni që edhe një herë të ju urojë gjithë qytetareve të Komunës së Vitisë. Natyrisht edhe para tri dite kaluam një proces zgjedhor që ishte një proces i qetë, u tregua një kulturë dhe një qytetari nga ana e qytetareve, ndërsa fituesin e zgjedhjeve e urojmë për fitoren. Diçka tjetër të veçantë të këtyre komiteteve nuk kemi për fakt. Ndoshta është mirë me ju tregua se numri i të infektuar me Covid është në ramje e sipër. A ka dikush para se me hy në rend dite për me marr fjalën ju lutem? Pasi që nuk ka, për këtë mbledhje të KPF-së kemi paraparë këtë:

### R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike).**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës se paluajtshme te Komunës në shfrytëzim ( parkingjet publike).**
6. **Informatë për planin e prokurimit për vitin 2021 (Janar-Dhjetor 2021).**

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm? Pasi që nuk ka e qes në votim që të miratohet rendi i ditës. Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

### 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm? Pasi që nuk ka e qes në votim. Konstatohet se me vota unanime miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

### 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës

Pasi që zyrtari është I nxanë, nëse ka nevojë me elaboruar nënkryetari është këtu, megjithatë fjala është për ju. Nëse keni diçka.

**z.Jakup Demiri:** Kanë qenë rrethanat e zgjedhjeve, unë po e la diskutimin tim për kuvend.

**z.Bekim Azizi:** Na vetëm një herë kemi diskutuar, tana ka qenë në diskutim publik, pas diskutimit publik vjen për miratim. Besoj se tash për kuvend kush shkojmë zyrtari do të na tregoj cilat kanë qenë ndryshimet që pas diskutimit publik kanë mund me I bërë përmirësimet, pasi që nuk është këtu na nuk mundemi me diskutuar, se nuk e dimë ku I ka bërë ndryshimet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush tjetër ju lutëm? Pasi që nuk ka, kush është që të shkoj për kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti

Ja Kisha kalua fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**znj.Hanife Januzi:** Ky propozim vendim është një akt administrativ që e funksionalizon organizmin, funksionimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Kujdesit Parësorë. Unë po e di se ndoshta nuk ka nevojë me lexuar nen për nen, por megjithatë presim që të shqyrtohet dhe të miratohet në kuvendin e ardhshëm që është një pikë shumë me rëndësi, që patjetër dhe doemos duhet të miratohet në seancën e kuvendit. Unë ma shumë nuk do ta zgjas, nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion që të ju ndihmojë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Faleminderit drejtoresh. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**znj.Xhelsyme Qamili:** Edhe unë e kuptoj që statuti është një akt që duhet të jetë funksional për ecurinë e punëve në mbarëvajtjen e Qendrës së Mjekësisë Familjare. Unë do të ndalem, na e dimë se ky statut është unik për krejt qendrat e Kosovës, I cili hartohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe i vjen kuvendit për miratim, duke I modifikuar apo duke I përshtatur specifikat për secilën vet e vet. Unë do të ndalem në faqe shtatë, po ma së pari këtë materialin që na ka ardhur nuk do të jap vërejtje, por një sugjerim që për kuvend le të shtypet pak ma mirë. Te neni 9, te departamenti i administratës së Qendrës së Mjekësisë Familjare, organizohet në Njësinë për Zyrën e Personelit, njësinë ose zyrën juridike. Këtë drejtoresh tu kisha lutë me u konsultuar me Zyrën Ligjore, a shkojnë këto te dy drejtoritë. Në 124, njësia e prokurimit për qendra të tjera që janë ma të mëdha, ndoshta kjo Zyre e Prokurimit kishte me kryer punë, mirëpo për mjekësinë familjare në Viti nuk e di a e keni diskutuar për këtë.

**znj.Hanife Januzi:** Përderisa ky statut u nxjerrë nga udhëzimi administrativ, d.m.th është në përputhje me ligjin, mirëpo megjithatë nëse parashihet që nuk ekziston mundësia, atëherë ju Zyrën e Prokurimit e keni, mirëpo është një efikasitet shumë ma i mirë nëse e kemi edhe Zyrën e Prokurimit.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A kemi të drejtë me pas ndërhyrje pasi që është më udhëzim administrativ nga ministria, mos duhet me i marr nga ministria udhëzimet për ndryshime.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Vetëm ta kemi të kjashtë, udhëzimi administrativ, d.m.th. ti ka caktuar pikat që brenda këtyre pikave duhet me u sillë, por e marrim shembull Qendrën e Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe Zyra e Prokurimit dhe zyra që është në komunë, nuk mund me i krye edhe të mjekësisë, se ka shumë, dhe aty e arsyetona, në Viti nuk ja vlen barra qiranë. Unë kisha me diskutuar edhe te Njësia e Personelit të cilën ne e kemi adaptuar atje, çka është në QKMF dhe tash e pash atje edhe Zyrën Juridike, u kanë mirë edhe këtë pasi e kemi një Zyre të

Personelit këtu, po na i kryen ato punë ne duhet me menduar në të ardhmen që kjo zyre juridike që është një emertim i sekretarit të përparshëm. Unë po mendoj që duhet me shikuar se aty nuk na duhen punëtor administrativ, por aty na duhen mjek. Edhe e treta, nuk ju ka nënshtruar dëgjimit publik, që mendoj se me punëtorët shëndetësor u dashtë me ju nënshtruar.

**z.Bekim Azizi:** Këtu te këshilli drejtues, përfaqësuesi I këshillit të pacienteve te neni 11: qysh përcaktohet, a është e paraparë me rregullore apo si? Edhe te neni 14, procedura për emërimin e drejtorit. Na e dimë që drejtori zgjidhet nuk emërohet. Kjo është mirë me u përmirësuar.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Dikush tjetër a ka? Nëse nuk ka më, vërejtjet që u paraqiten e qes ne votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike)**

**znj.Idajete Aliu:** Propozim vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, bëhet fjalë për parkingjet publike që janë në qytet. Ne kesi leje kemi dhanë edhe ma herët. Për ma shumë nuk dua të ju marr kohë. Për ndonjë pyetje apo ndonjë sqarim jam në dispozicion të ju ndihmoj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë desha vetëm një pyetje, a janë paraparë edhe ato mbrapa shtëpisë së kulturës, sepse edhe andej kanë paguar. Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**z.Bekim Azizi:** Siç e kuptova edhe unë, vetëm prej pasqyrës edhe deri te komuna është paraparë apo.

**z.Jakup Demiri:** Parkingje pa pagesë ma nuk ka asnjë, edhe nëse e bien një të moshuar në bankë, ai duhet t'i paguaj 30 cent plus. Tjetra, mbrapa shtëpisë së kulturës nuk e di se si ju ka dhanë atyre, vetëm se tash duhet me u sqaruar ajo pjesë. Tjetra, është rregulluar kjo pjesa e sheshit, por ata si duket janë tu funksionar në aspekt jologjor për shkak se nuk është paraparë as me kontratë as me kurgja.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Pjesën mbrapa shtëpisë së kulturës ja kanë dhanë deri në përfundim të kontratës si kompensim të kësaj që e kanë marr për ndërtimin e sheshit deri në përfundim të kontratës.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Nëse nuk ka dikush tjetër, kush është që të shkoj për kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Faleminderit! Shkon për kuvend edhe kjo pikë.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

#### **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës se paluajtshme te Komunës në shfrytëzim ( parkingjet publike)**

**znj.Idajete Aliu:** Edhe për këtë propozim vendim duhet të formohet komisioni paraprak. Ne e kemi formuar një komision, i kemi propozuar dy anëtarë, dy tjerë janë prej kuvendi që duhet me I propozuar dhe një nga shoqëria civile.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush me diskutuar rreth kësaj pike të rendit të ditës. Pasi që nuk ka, e hedhim në votim që të shkoj për miratim edhe kjo pikë. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër te rendit të ditës kemi:

#### **6. Informatë për planin e prokurimit për vitin 2021 (Janar-Dhjetor 2021)**

Ja kaloj fjalën zyrtarit te prokurimit.

**z.Fadil Abazi:** Unë e kam dërguar një plan të prokurimit, nuk e di a ka nevojë me lexuar, sepse është shumë, por nëse ka ndonjë pyetje jam në dispozicion të ju ndihmoj.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

**z.Bekim Azizi:** Unë do të lidhem, p.sh asfaltimi I rrugëve, ky është projekt I mëhershëm. Pse ka nevojë me u shpall prapë, se nuk ke nevojë me shpall, pasi që është projekt dyvjeçar.

**z.Fadil Abazi:** Ky është projekt dyvjeçar, vitin e kaluar është mbyll, tash 62 mijë euro e shpallim për pjesën e dytë. Ne nuk kemi nevojë me shpall ma, kjo është vetëm për pagesa, planin e prokurimit e tregon, përndryshe nuk mund të alukohen mjetet.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Dikush tjetër a ka me diskutuar diçka ju lutëm. Pasi që nuk ka, kjo pikë nuk shkon për kuvend. Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje .

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Naim Pira**

---